REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

Maliq, më 05.01.2026

Projekt-Vendim

Mbi përdorimin e fondit për projektin ***"Shërbime mbështëtëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar"*** me financim të përbashkët nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Maliq, viti i katwrt.

Në mbështetje të ligjit nr . 139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republiken e Shqiperisë", dhe ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", dhe vkm-së nr. 518, datë 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar", si dhe shkresës nr. 5055/27 prot, datë 29.12.2025 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për celjen e fondit prej lekë për vitin 2026.

Kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Maliq:

1. Të miratojë përdorimin e fondit të deleguar nga Fondi Social i MSHMS me vlerë totale lekë (për vitin 2026) për zbatimin e projektit ***"Shërbime mbështëtëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar"***, të detajuar si më poshtë ;
   1.1 Miratim fondi me vlerë 1152232 lekë për paga dhe sigurime të punonjësve si dhe shpenzimet operative që do të ofrojnë këtë shërbim sipas buxhetit të projektit;

Nr	Aktiviteti	Emertimi pozicionit	Llogaria 600	Llogaria 601	Llogaria 602	Shuma
1	1 punonjes	Koordinator shërbimi(paga 58000 leke /muaj)	696000	116232		812232
2	Shpenzime operative /	Banke ushqimore			190000	190000
		Kosto administrative (karburant Gaz oil)			100000	100000
3	Mbeshtetje direkete ne familje	Ndihme financiare per shpenzime mjekesore			50000	50000
Totali			696000	116232	340000	1152232

2. Ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi mbas miratimit nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë .

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi : Dr. Drejtoria E Shërbimit Social Arsimit Dhe Shëndetësisë	E.Petriti		Dt 05.01.2026

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë www.bashkiamaliq.gov.al Tel. & Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

Maliq, më 05.01.20256

Relacion

Mbi projektin ***"Shërbime mbështëtëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar"*** me financim të përbashkët nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Maliq

Në mbështetje të ligjit nr . 139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republiken e Shqiperisë", dhe ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e shqipërisë", dhe vkm-së nr. 518, datë 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar", Bashkia Maliq në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Vazhdon shërbimin në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar .

Përfitues të këtij shërbimi janë banorë të moshuar të vetmuar në Bashkinë Maliq; familjet e personave me afteëi të kufizuar , persona me aftësi të kufizuar ; familjet dhe qytetarët në nevojë. punonjësve sociale. rrethi i gjerë familjar i familjeve target; punonjës të strukturave të posaçmetë shërbimeve sociale pranë bashkisë; punonjësit e shërbimit social shtëtëror; punonjësit e njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit në çdo njësi administrative; profesionistë të tjerë të shërbimeve psikosociale të sitemit shëndetësor dhe arsimor në nivel vendor.

Aktivitetet kryesore të këtij shërbimi do të jenë

1. *Mbeshtetje higjeno-sanitare ne familje*
2. *Sigurimi i aksesit në rrjetet e shërbimeve në komunitet*
3. *Mbështje për aftësim profesional, punësim per familjet me persona me AK*
4. *Ofrimi i kujdesit afatshkurtër në shtëpi.*
5. *Identifikim dhe referim për mbështetje, i ndihmesit personal te personave ne nevoje*
6. *Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese për gjithperfshirjen e personave me AK dhe per moshen e trete*
7. *Trajnime të stafit mbi shërbimin në familje*

Shuma e deleguar nga Fondi Social për vitin 2026 është 1152232 lekë

Ky shërbim do të përfshijë kryesisht të moshuar të vetmuar në nevojë për mbrojtje duke ju ofruar atyre kujdes higjenosanitar ne banesë , kujdes afatshkurter për nevoja të ndryshme si mediikamente , mbështetje në natyrë me paketa veshje dhe eleltro shtëpiake sipas rastit dhe problematikave të tij, infromim dhe orientim drejt shërbimeve të tjera të ofruara nga aktorë të ndryshëm lokalë , aktivitete të ndryshme etj.

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi : Dr. Drejtoria E Shërbimit Social Arsimit Dhe Shëndetësisë	E.Petriti		Dt 05. 01.2026

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu